

Programi për Reforma në Sektorin e Zbulimit dhe Sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2026)

BULETINI INFORMATIV NR.2

TETOR - DHJETOR 2021



Nënshkrimi i Memorandumit për Bashkëpunim me Kuvendin e Maqedonisë së Veriut

Shkup, 19 nëntor 2021

Programi për Reforma në Sektorin e Zbulimit dhe Sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2026) filloi zyrtarisht në datë **1 prill 2021** si vazhdim i procesit të reformave demokratike në sektorin e sigurisë.

Periodha tetor-dhjetor 2021 ishte mjaft sfiduese si në aspekt të pandemisë së prolonguar të Covid-19, ashtu edhe në aspekt të ndikimit që kishin zgjedhjet lokale.

Megjithatë, DCAF vazhdoi fokusin në aktivitetet hibride (si online ashtu edhe offline) për të vijuar misionin për të siguruar qeverisje të mirë në sektorin e zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut.

Gjatë kësaj periudhe, në **18-19 nëntor 2021**, Drejtori i DCAF-it, Ambasadori Tomas Gerber, zyrtarisht nënshkroi **Memorandum Bashkëpunimi (MB) me Kuvendin e Maqedonisë së Veriut dhe Marrëveshje Bashkëpunimi (MB) me Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë dhe me Agjencinë Teknike Operative (ATO).**

Ceremonitë e nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve shënuan fillimin e një faze të re të ndërtimit të shërbimeve të sigurisë që në Maqedoninë e Veriut do të qeverisen në mënyrë efektive dhe llogaridhënëse.

DCAF dhe QSS/RSS

Që nga themelimi në vitin 2000, DCAF - Qendra e Gjenezës për Qeverisje me Sektorin e Sigurisë ka kontribuar duke bërë paqen dhe zhvillimin më të qëndrueshme me ndihmën që u ofron këtyre shteteve që të rrisin cilësinë e qeverisjes së sektorit të sigurisë me reforma gjithëpërfshirëse. DCAF krijon produkte inovative njohurish, promovon normat dhe praktikat e mira, ofron këshilla ligjore dhe për politikbërje, dhe mbështet ndërtimin e kapaciteteve si të palëve që veprojnë në fushën e sigurisë- qofshin ato shtetërore apo jo. DCAF është një nga organizatat kryesore në botë në fushën e qeverisjes me sektorin e sigurisë (QSS) dhe reformat në sektorin e sigurisë (RSS).

Arritjet kryesore dhe kontributi i DCAF-it mund të shihen në [videon](#) më të re.



Nënshkrimi i Marrëveshjes për Bashkëpunim me Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë

Shkup, 18 nëntor 2021



Nënshkrimi i Marrëveshjes për Bashkëpunim me Agjencinë Teknike Operative

Shkup, 18 nëntor 2021

REZULTATI I

Me qëllim të rritjes së cilësisë së ligjeve ekzistuese dhe kapacitetit të organeve të jashtme mbikëqyrëse për mbikëqyrje efektive dhe transparente, **u mbajt Takim Pune me Komisionin holandez për Mbikëqyrje të Shërbimeve të Zbulimit dhe Sigurisë (KMSHZS)** në Gjenevë në **26 tetor 2021**. Në këtë takim pune vëmendja ishte tek ligjet aktuale maqedone (sistemi i institucioneve të zbulimit, mekanizmat për mbikëqyrje, organet, etj.) si dhe u eksplorua mundësia për të angazhuar KMSHZS për të analizuar dhe këshilluar kolegët nga Maqedonia e Veriut, për përmirësime të mundshme në ligjet maqedone që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e sektorit të zbulimit.

Mekanizmi i Partnerëve Zhvillimorë për Udhëheqje

Për këtë program u zgjodh mekanizmi i financimit të përbashkët dhe deri në dhjetor 2021 kanë kontribuar katër Partnerë Zhvillimorë. Këta janë Holanda (CHF 780'000), Suedia (rreth CHF 960'000), Zvicra (CHF 1'000'000), dhe Bashkimi Evropian (rreth CHF 320'000). Bashkë me kontributin vetanak të DCAF-it dhe mbështetjen me mjete jofinanciare nga partnerët përfitues, pra me sigurimin e zyrave, vendtakimeve, pajisjeve teknike, transportin lokal, dhe ekspertët, buxheti i përgjithshëm për periudhën 2021-2026 arrin CHF 4'939'219.

Ky Program udhëhiqet nga grupi i Komisioneve Udhëheqëse me partnerë të vendit përfitues dhe nga Grupi Udhëheqës i Partnerëve Zhvillimorë (GUPZH). GUPZH përbëhet nga Ambasadorët dhe ekipi i programit i nivelit të lartë. Ata angazhohen në mënyrë aktive me Programin duke ofruar këshilla politike dhe strategjike, këshilla për zbatim të rreziqeve dhe efektivitet në zbatim. Takimet e GUPZH mbahen një herë në tre muaj dhe organizohen nga misionet e Partnerëve Zhvillimorë me rotacion.

REZULTATI II

Nga **9-11 nëntori 2021**, DCAF organizoi **Dialogun Parlamentar për Qeverisje dhe Mbikëqyrje të Zbulimit në Ballkanin Perëndimor**. Kjo ngjarje u mbajt në Shkup dhe bëri bashkë 18 parlamentarë dhe këshilltarë të stafit parlamentar nga komisionet e sigurisë dhe zbulimit nga Parlamentet e Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, si dhe ekspertë ndërkombëtarë dhe të vendit që kontribuan në diskutim. Diskutimet u fokusuan

Programi për Reforma në Sektorin e Zbulimit dhe Sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Prill 2021 - Mars 2026

Në vazhden e arritjeve të fundit, qëllimi i këtij Programi është të vijojë me procesin e reformave demokratike në sektorin e sigurisë në Maqedoninë e Veriut. Strategjia e intervenimit ka për qëllim të sigurojë që shërbimet e zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut funksionojnë siç duhet nën kontrollin dhe mbikëqyrjen aktive demokratike duke luftuar kundër krimeve serioze të organizuara dhe duke frenuar korrupsionin në përputhje me praktikatat e mira të llogaridhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Ky Program është i strukturuar për të arritur tre rezultate:

Rezultati I: Ndryshim dhe plotësim i kornizave ligjore dhe institucionale në sektorin e zbulimit në Maqedoninë e Veriut në përputhje me parimet relevante Euro-Atlantike dhe praktikatat e mira të llogaridhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Rezultati II: Organe të mbikëqyrjes së jashtme dhe kontrollit fitojnë njohuri dhe forcojnë kapacitetet për të zbatuar mbikëqyrje transparente dhe efektive të aktiviteteve që bën sektori i zbulimit.

Rezultati III: Opinioni informohet lidhur me funksionalitetin dhe rezultatet e sistemit të llogaridhënies së sigurisë dhe zbulimit.

Partnerët për zhvillim: Holanda (Ministria e Punëve të Jashtme), Suedia (Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim - Sida), Zvicra (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim - SDC) dhe Bashkimi Evropian.

Partnerët në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

- Kuvendi i Maqedonisë së Veriut
- Zyra e Kryeministrit
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Mbrojtjes
- Shërbimet e sigurisë dhe zbulimit
- Agjencia Teknike Operative (ATO)
- Agjencia për Mbrojtje të të Dhënave Personale
- Drejtoria për Siguri të Informatave të Klasifikuara
- Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë
- Zyra e Prokurorit Publik kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
- Gjykata dhe institucione të tjera gjyqësore
- Avokati i Popullit
- Revizioni i Shtetit
- OJQ-të dhe mediet

tek tendencat dhe zhvillimet e reja që kërkojnë qasje inovative për mbikëqyrjen e zbulimit. Pjesëmarrësve iu dha mundësia të takohen me kolegët e tyre dhe të këmbëjnë përvoja lidhur me temat prioritare. Ky takim, të cilin e hapi Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Z. Talat Xhaferi, ishte thelbësor për lehtësim të transferit të njohurive lidhur me qeverisjen dhe mbikëqyrjen e sektorit të zbulimit dhe për vendosjen e themeleve për bashkëpunim të mëtejshëm ndër-parlamentar.

Aktivitetet për rritje të kapaciteteve të deputetëve u shtuan në numër me **një sërë takimesh individuale/të veçanta lidhur me rritjen e vetëdijes me anëtarët e tri komisioneve parlamentare për mbikëqyrje**. Këto takime, që u zhvilluan në **dhjetor 2021**, kontribuan në rritje të vetëdijes dhe njohjes së prospekteve, përfitimeve dhe sfidave të proceseve mbikëqyrëse të sektorëve të zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut.

Veç kësaj, DCAF mori përsipër edhe përkthimin në gjuhën maqedone dhe shqipe të dy botimeve që synojnë ndërtimin e kapaciteteve në pjesën e detyrave të zbulimit dhe prokurimit të zbulimit. Botimi i parë **“Roli i parlamenteve në mbikëqyrjen e përcaktimit të detyrave për intelgjencën”** jep udhëzime të rëndësishme për atë se si parlamentet në mënyrë efektive mund të vendosin kritere dhe prioritete që përkufizojnë shpenzimet e agjencive të zbulimit dhe mbledhjen e analizave të zbulimit. Botimi i dytë **“Prokurimi i zbulimit”** ka për qëllim të minimizojë rrezikun e proceseve të prokurimeve publike duke ofruar udhëzime lidhur me menaxhimin e prokurimeve publike që bazohen në parime thelbësore, siç janë transparenca, gara e drejtë, dhe mos-diskriminimi.



Pjesëmarrësit në punëtorinë nr. 1 për TT për nëpunësit juridikë dhe gjyqësorë, Ohër, 20-22 tetor 2021

Në përputhje me Rezultatit II të Programit, DCAF organizoi pesë **punëtori për Trajnim të Trajnerëve (TT)** mbi shtrirjen dhe shpërndarjen për personat që veprojnë në fushën e gjyqësisë, me titull **“Nga teoria në praktikë: Avancimi i praktikave gjyqësore mbi mbikëqyrjen e Masave të Posaçme Hetuese (MPH) me përdorim të Metodave të fitimit të njohurive të reja që mbesin nmbesin në kujtesë”**. Punëtoritë e këtilla bazohen tek [Doracak](#) i botuar para ca kohësh dhe kanë në fokus ndërtimin e kapaciteteve të praktikuesve të ligjit për të ofruar sesione trajnimi, në mënyrë që është konsistente me parimet konceptuale të nxënies transformuese dhe aktive tek të rriturit. Këtu bën pjesë edhe bartja e përmbajtjeve (transmetimi i informacionit konceptual) pasuar nga zbatimi praktik dhe ushtrimet praktike me publik live për praktikuesit e ligjit.



Dialog parlamentar mbi qeverisjen dhe mbikëqyrjen e kundërzbulimit në Ballkanin Perëndimor

Shkup 9-11 nëntor 2021

Punëtorja e parë TT u mbajt nga **20 - 22 tetori** në Ohër, kurse e dyta nga **15 - 17 dhjetori** në Gjevgjeli, që të dyja në Maqedoninë e Veriut. Caku kryesor që targetohet me këto punëtori TT janë 12 trajnerët nga Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë dhe ata persona që kanë kontribuar tek Udhëzuesi, disa gjykatës dhe prokurorë nëpër tërë vendin, si dhe përfaqësues nga organet e autorizuara për zbatim të MPH (Ministria e Brendshme, Drejtoria e Doganave, Policia Financiare).

DCAF vazhdoi kontributin për forcim të kapaciteteve tek gjykatësit dhe personelin gjyqësor me fokus në bashkëpunimin gjyqësor dhe ndihmën lidhur me përdorimin e standardizuar të MPH.

Në këtë drejtim, në bashkëpunim me programin e DCAF-it për drejtësi dhe siguri u organizua virtualisht **Konferenca Rajonale për Gjyqësorin** me temë **“Ndhimja ndërkombëtare ligjore për çështjet penale”** në **9 dhjetor 2021**. Në këtë konferencë u diskutuan çështjet si bashkëpunimi juridik me kornizat që ofrojnë EUROJUST-i, EUROPOL-i dhe KBP EJL-ja (Konventa për Bashkëpunim Policor – Evropa Juglindore), dhe standardet për përdorim të MPH në kuadër të ndihmës ndërkombëtare juridike. Në këtë takim u mblodhën mbi 50 profesionistë nga fusha e gjyqësisë dhe akademisë nga disa vende të Evropës Juglindore (përfshirë këtu edhe Maqedoninë e

Veriut) për të diskutuar angazhimet aktuale me ndihmën ndërkombëtare juridike që iu ofrohet si dhe me sfidat e hetimeve penale ndërkufitare. DCAF do të vazhdojë të mbështesë gjyqësorin me organizim të ngjarjeve rajonale dhe formave të tjera të këmbimit të njohurive dhe përvojave që asistojnë forcimin e kapaciteteve për të qenë pjesë e hetimeve paralele penale.

Në po këtë drejtim, në **20 dhjetor 2021** u mbajt **Diskutim ekspertësh** në temën **“Roli i ndihmësve juridikë në zhvillimin e praktikës gjyqësore”**. Në këtë diskutim, nëpunësve gjyqësorë iu dha mundësia të diskutojnë veçantitë që ka puna e tyre dhe sfidat me të cilat ballafaqohen ata gjatë përgatitjes së këshillave të elaboruara juridike për Gjykatat dhe Zyrat e Prokurorëve. Në këtë ngjarje pjesëmarrësit këmbyen përvoja dhe përshtypje lidhur me evolucionin e praktikës gjyqësore në përdorimin e MPH për mbledhjen e provave gjatë hetimeve penale dhe diskutuan lidhur me sistemin ligjor evropian të kësaj fushe që po zhvillohet me hapa të shpejtë. Ngjashëm me Bosnje dhe Hercegovinën, lancimi i përmbledhjes së rasteve gjyqësore në vend që pasqyrojnë zbatimin e MPH do të bëhet këtë vit në Maqedoninë e Veriut, duke kontribuar kështu në integrimin e parimeve dhe standardeve evropiane. DCAF do të vazhdojë dialogun dhe këmbimin e informatave për të mbështetur ata në avancimin e njohurive të nevojshme për të mbështetur gjyqësorin.



Nga **22-24 tetori në Dojran**, për të punësuarit në Agjencinë për Mbrojtje të të Dhënave Personale (AMDHP) në Maqedoninë e Veriut, u organizua **punëtorja me temë “Hartimi i procedurave për klauzola standarde kontraktuese për bartje të të dhënave personale”** (miratuar nga Komisioni Evropian në përputhje me GDPR që do të jetë valide në ligjet maqedonase). Në punëtori kishte një sërë ushtrimesh dhe diskutimesh që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e organeve të autorizuara nga sektori i sigurisë dhe zbulimit, për sa i përket ligjshmërisë së aktiviteteve të ndërmarra për procesim të të dhënave personale, si dhe masat për mbrojtjen e tyre sipas Ligjit për mbrojtje të të dhënave personale.

Nga **16-17 nëntori 2021** në Veles, Maqedoni e Veriut u mbajt **ushtrimi praktik me më shumë palë relevante** me temë **“Zbatimi i Standardeve të Përbashkëta Minimale për zbatim të vizitave mbikëqyrëse në institucionet e sigurisë dhe zbulimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut”**. Në këtë ushtrim u mblodhën nëpunës nga

institucionet e zbulimit dhe sigurisë që janë përgjegjës për bashkëpunimin ndër-institucional, dhe nëpunës nga institucionet që kanë për detyrë mbikëqyrjen dhe/ apo kontrollin brenda sektorit të zbulimit dhe sigurisë – gjithsej 18 përfaqësues nga këto institucione. Në këtë ushtrim pjesëmarrësve iu prezantua përmbajtja e materialit [Standardet Minimale të Përbashkëta \(SMP\)](#) dhe u testua zbatueshmëria e tyre përmes ushtrimeve praktike të simuluar, përgatitur nga ekspertët e vendit gjatë **dy takimeve përgatitore** (organizuar në **7 tetor dhe 8 nëntor 2021** respektivisht). Pjesëmarrësit bënë identifikimin e zbrazëtirave dhe paqartësive që parandalojnë kontrollin dhe mbikëqyrjen efektive të kundërzbulimit dhe diskutuan efektivitetin dhe kufizimin e procedurave aktuale të mbikëqyrjes. Grupi i pjesëmarrësve poashtu diskutoi mbi opsionet për rritje të cilësisë së praktikave të mbikëqyrjes dhe kontrollit – proces që zhvillohet në nivel të vendit, të cilin DCAF do të vazhdojë të mbështesë.



REZULTATI III

Për sa i përket rritjes së besimit tek opinioni, DCAF vijoi bashkëpunimin e zgjeruar me OJQ-të dhe partnerët nga mediat, duke u fokusuar në promovim të një diskursi publik që ka informacionin e nevojshëm dhe që udhëhiqet nga opinioni në vend. Gjatë kësaj periudhe u mbajtën takime dhe diskutime bilaterale, duke mbledhur ide dhe propozime shqyrtuese për iniciativa të përbashkëta që përshtaten me qëllimet e Programit tonë. Në muajt tetor-dhjetor 2021, DCAF pranoi dhe shqyrtoi propozimet e OJQ-ve dhe mediave për bashkëpunim duke mbështetur intervenime individuale të OJQ-ve dhe mediave që do të fillojnë në shkurt, 2022.

Në bashkëpunim me 360 Shkallë, DCAF filloi produksionin dhe transmetimin e **storjeve dokumentare audio-vizuele** në stacionin televiziv nacional ALSAT, me qëllim të informimit të opinionit të gjerë lidhur me arritjet, proceset e reformave dhe sfidat që lidhen me sektorin e zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut.

Mini-dokumentari i parë u transmetua në **tetor 2021**, me fokus në [Balancin gjinor në ushtri, polici dhe brenda disa shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit](#). Ky dokumentar ka si qëllim primar të promovojë dhe të rrisë vetëdijen e ndjeshmërisë gjinore dhe gatishmërisë gjinore në sektorin e sigurisë, që përbëjnë parime udhëheqëse në zbatimin e Programit për Reforma në Sektorin e Zbulimit dhe Sigurisë në Maqedoninë e Veriut. Dokumentari thekson progresin që është arritur për barazinë gjinore në këtë sektor që nga viti 2018 (si me ligj ashtu edhe në praktikë) dhe argumenton këtë progres me storie personale nga gra që kanë pozita të larta në ushtri, polici, apo në shërbimet e zbulimit.

Mini-dokumentari i dytë u transmetua në **nëntor 2021**, me fokus në [ngjarjet kryesore që lidhen me ceremonitë nënshkruese të MB dhe Marrëveshjes për Bashkëpunim dhe fillimit zyrtar të Programit të ri](#). Poashtu në këtë dokumentar theksohen arritjet e DCAF-it dhe qëllimet për rritje të cilësisë së qeverisjes së sektorit të zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut.

Pamje nga mini-dokumentari për barazinë gjinore
tetor 2021



AKTIVITETET E ARDHSHME

JANAR 2022

- Vlerësimi ekspertëve në terren për kapacitetet e procedurave ekzistuese për procesim dhe këmbim të të dhënave të automatizuara të ADN-së në Sektorin e Mjeksësisë Ligjore në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Maqedoninë e Veriut
- Punëtori për Rregulloren (RRP) për përdorim të Dhomës së Izoluar "Koncepti dhe plani i përgjithshëm" - Nr.1
- Produksioni dhe transmetimi i storjes në formë të mini-dokumentarit në TV nacionale në Maqedoninë e Veriut me titull Mbikëqyrja Qytetare dhe Demokratike e Sektorit të Sigurisë

SHKURT 2022

- Punëtori dhe diskutim "Analiza e zbrazëtirave tek Ligji për ndjekje të komunikimeve (LNK) dhe Ligji për Agjencinë Teknike Operative (ATO)", Maqedoni e Veriut
- Punëtori për deputetët: Inkorporimi Gjinor në Mbikëqyrjen e Kundërzbulimit, Shkup (fk)
- Punëtori për Rregulloren (RRP) për përdorim të Dhomës së Izoluar - Nr.2
- Fillimi i mbështetjes së aktiviteteve/intervenimeve të OJQ-ve individuale dhe mediave me mentorim të DCAF-it
- Seanca trajnuese/punëtori për forcim të mekanizmave të brendshme kontrolluese të MPB-së (mbrojtja e informatorëve), Shkup

MARS 2022

- Tavolinë e rumbullakët në temë Roli i Parlamentit në Qeverisjen e Kundërzbulimit, Gjenevë, Zvicër (fk)
- Punëtorja për Manualin për TT Nr. 3 për ekspertët juridikë dhe gjyqësor: Nga teoria në praktikë - Avancimi i praktikave gjyqësore lidhur me mbikëqyrjen e Masave të Posaçme Hetimore (MPH) me përdorim të Metodave për Nxënie dhe Ruajtje të Njohurive, Berovë apo Strumicë, Maqedoni e Veriut
- Punëtori mbi Rregulloren (RRP) për përdorim të Dhomës së Izoluar - Nr.3
- Trajnim me temë Mbikëqyrja Qytetare dhe Qeverisja e Mirë e Sektorit të Sigurisë për OJQ-të dhe mediat, Ohër, Maqedoni e Veriut (fk)
- Përgatitja dhe botimi i Katalogut të shërbimeve/Broshura me shërbimet forenzike të MPB-së
- Produksioni dhe transmetimi i storjes në formë të mini-dokumentarit në televizionin nacional në Maqedoninë e Veriut me temë "Digjitalizimi dhe Reformat dhë Sektorin e Zbulimit dhe Sigurisë"